

Të dhënat kryesore të projektit **DSP II –35** zbatuar nga **LENS**

Emri i projektit:	“ Rregullatori yt“
Zbatuar nga:	LENS
Partnerët nëse ka:	
Fushat prioritare të DSP-së:	1.2, 1.1
Qëllimi i projektit:	Ky projekt ka për qëllim të rris transparencën dhe llogaridhënien për punën e Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postale (ARKEP) dhe Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ASHMDP), dy autoriteteve kryesore që kanë ndikim në kualitetin dhe sigurinë e komunikimit elektronik të Kosovës, si dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve në formën e lejimit të qarkullimit të lirë të informatave, kualitetit të tyre, si dhe mbrojtjen e qytetarëve nga shkelja e privatësisë. Synimi është që të informohen qytetarët për rolin dhe funksionin e këtyre trupave rregulluese, si dhe të fuqizohen, në mënyrë që të rrisin presionin publik për aplikimin e standardeve më të larta të etikës në punën e institucioneve publike në përgjithësi dhe rregullatorëve në veçanti.
Rezultatet e projektit:	<p>R1. Rritet sasia e informacionit dhe ngritët vetëdija qytetare për rolin dhe funksionimin e ARKEP dhe ASHMDP, me theks të veçantë në shërbimet e tyre ndaj qytetarëve, shpenzimet e këtyre autoriteteve dhe rezultatet e punës. Informohen më shumë se 200.000 qytetarë rreth punës së 2 rregullatorëve, me përqendrim tek puna që prek direkt qytetarët, duke potencuar çështjet kryesore që janë në interes të qytetarëve.</p> <p>R2. Krijohet një praktikë e avokimit dhe aktivizmit qytetarë për çështjet kryesore të identifikuar. Projekti do të shërbejë si mjet komunikimi në mes të qytetarëve, shoqërisë civile nga njëra anë, dhe dy rregullatorët dhe Kuvendi në anën tjetër. Rezultati konkret është përmirësimi i dukshëm i punës së rregullatorëve dhe rritja e ndjeshme e transparencës së tyre, si dhe angazhimi më i thellë dhe i evidentueshëm i Kuvendit në monitorim të rregullatorëve. Kjo praktikë do të zhvillohet direkt dhe online. Si rezultat përfundimtar do të jenë shërbime më të mira dhe më të sigurt të telekomunikimit për qytetarët e Kosovës.</p> <p>R3. Mediat aftësohen që të bëjnë raportime të sakta dhe informuese mbi punën e autoriteteve rregullative dhe fushëveprimin e tyre. Synojmë të promovojmë rritjen e presionit publik pozitiv ndaj funksionarëve shtetërore, në dobi të respektimit të standardeve të etikës dhe integritetit, duke besuar se iniciativa jonë do të çojë drejt adaptimit të praktikave më të mira nga ana e 2 rregullatorëve në fjalë, si dhe nga ana e institucioneve mbikëqyrëse, përfshirë shoqërinë civile.</p>
Aktivitetet Kryesore:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Analiza e bazës ligjore, funksionimit, rolit dhe punës së autoriteteve rregulluese. 2. Përkrahja në internet e grupeve të synuara 3. Përkrahja e grupeve të synuara 4. Fushata
Shtrirja gjeografike:	Kosovë
Grupet e synuara:	Qytetarët, ARKEP dhe ASHMDP, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve vendore, sidomos ato që punojnë në fushën e sigurisë së informacionit dhe të dhënave personale
Buxheti i financuar nga DSP:	24876.78 EUR
Bashkëfinancimi dhe shuma (nëse ka)	
Personat Përgjegjës dhe kontaktet e tyre: e-maili, telefonat	Bardha Ahmeti, bardha@ngolens.org +381 38748150 Driton Zhubi, drejtor ekzekutiv zhubi@ngolens.org +381 38748150
Kontaktet e Organizatës: Adresa, e-maili, telefonat.	Lens Rr. Sylejman Vokshi, 25, Nr.6 10 000 Prishtinë info@ngolens.org +381 38748150
Webi dhe rrjetet sociale të projektit:	www.ngolens.org ; www.rregullatori.com facebook: https://www.facebook.com/ngolens ,twitter: @ngolens